



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KA.nr.2-7/22

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në KOLEGJIN e përbërë nga av.Kadri Sylaj–Kryetar, av.Drenusha Berisha dhe av.Ruzhdi Berisha –anëtarë, me pjesëmarrjen e Ma.sc Vjolleca Ajeti administratore e Zyrës Disiplinore të OAK-së në cilësinë e procesmbajtëses, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar nga i paraqituri av. _____ e ushtruar kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor V.KD.nr.2-4/21 të datës 22.02.2022, në seancën jopublike të mbajtur më 25.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e ushtruar nga i paraqituri _____ e protokoluar me nr.2-5/2022 e datës 11.03.2022.
- II. **NDRYSHOHET** Vendimi i Komisionit Disiplinor V.KD.Nr.2-4/21 i datës 22.02.2022, ashtu që ndaj av. _____ **PUSHOHET** Procedura Disiplinore për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes disiplinore.
- III. **Shpenzimet** e Procedurës Disiplinore bien në barrë të OAK-së.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës nëpërmes Kolegjit Disiplinore me Vendimin V.KD.nr.2-4/21 të datës 22.02.2022, në pajtim me nenin 51 par.1 nën par.1.1 të Ligjit për Avokatinë, nenit 122 të Statutit të OAK-së, të paraqiturit av. _____ nga _____ i ka shqiptuar masën disiplinore **VËREJTJE** si dhe e ka obliguar që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 50.00 (pesëdhjetë) euro.

Kundër këtij Vendimi, i paraqituri av. _____ nga _____ a ka ushtruar ankesë në afatin ligjorë, mbi bazën juridike të parashkrimit absolut sipas nenit 56 paragrafi 2 i Ligjit për Avokatinë.

Ushtruesi i ankesës Vendimin e shkallës së parë e ka atakuar duke u bazuar në nenin 56 par.2 të Ligjit për Avokatinë, duke theksuar se: 'fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe për kryesin, kurse gjithsesi parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes', pasi

që shkelja disiplinore ka ndodhur me datën 25.02.2020, si që vërtetohet edhe në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë që vendimi i atakuar nuk është ende i plotëfuqishëm, atëherë konsiderojmë se procedura disiplinore duhet të pushohet dhe i propozojmë titullit të lartëshënuar që të marrë vendim si në dispozitiv të kësaj ankese.

Komisioni për ankesa- Kolegji si organ i shkallës së dytë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore të theksuara me ankesë lidhur me Vendimin e atakuar në mbështetje të nenit 110 par.1 dhe 2 të Statutit dhe neneve 46,49,52 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar, ngase pretendimet ankimore të ankuesit kanë mbështetje në dispozitat normative pozitive aktuale të OAK-së, Statutit nenit 127 dhe Ligjit për Avokatinë nenit 56 paragrafi 2 me të cilat taksativisht parashifet Parashkrimi i ndjekjes disiplinore.

Komisioni i ankesave- Kolegji me rastin e vendosjes lidhur me ankesën ka vlerësuar gjendjen faktike lidhur me këtë qështje disiplinore, konkretisht qështjen e parashkrimit të ndjekjes disiplinore, duke pas parasysh faktin se shkelja disiplinore ka ndodhur me datë 25.02.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar, sipas fletëparaqitjes me nr.27/20, e ushtruar nga Gjyqtarja nga Gjykata Themelore në Gjakovë, në të cilën seancë av. nga qenë i caktuar sipas detyrës zyrtare nga OAK, si mbrojtës i të pandehurit nga , për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313, par.1 të KPRK-së, i njejtë pasi është lexuar aktakuza ka reaguar në drejtim të Prokurorit (siq është shënuar në Propozimin e Prokurorit Disiplinore) me fjalët : unë nuk i besojë aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjakovë , po ashtu i drejtohet prokurorit: juve do t'iu tregoj vetingu etj., ku Prokurori i qështjes ka kërkuar nga Gjykata që të ndërpritet seanca dhe të ndërmeren masa meqë këto sjellje i ka cilësuar si fyerje. Si provë ka dërguar procesverbalin e shqyrtimit fillestar P.nr.367/19 të datës 25.02.2020. Bazuar në ankesën e të paraqiturit av. , Kolegji i Ankesave pas analizimit të provave të bashkagjitura në këtë qështje disiplinore, ka ardhur në përfundim se shkelja disiplinore ka ndodhur me datë 25.02.2020, ndërsa Vendimi i Kolegjit Disiplinore është marrë me datë 22.02.2022, andaj bazuar në nenin 56 par.2 të Ligjit për Avokatinë, ku thuhet citoj: 'fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe për kryesin, kurse gjithsesi parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes', konsiderojmë se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes disiplinore ngase një parashkrim i tillë është arritur me datë 25.02.2022, pra 3 ditë pasi që ka vendosur Komisioni Disiplinorë - Kolegji i shkallë së parë me datë 22.02.2022 dhe me të drejtë është Aprovuar si e bazuar ankesa e të paraqiturit av.

andaj edhe është Pushuar Procedura Disiplinore për shkak të parashkrimit abosult të ndjekjes disiplinore, ngase nga koha kur ka ndodhur shkelja disiplinore kanë kaluar mëtepër se dy (2) vite.

Nga të theksuarat më lartë u vendos si në dispozitivin e Vendimit në pajtim me nenin 46 par.1 nën par.1.3 të Rregullorës për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
Prishtinë, V.KA.Nr.2-7/22 , datë 25.03.2022

Kryetar i Kolegjit

Avokat Kadri Sylaj

